



Prishtinë, 27 shkurt 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_892\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 19 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V-671-2014 të datës 23 dhjetor 2014;
- Vendimin mbi Pranimin në Skemën Mbështetëse V-700-2015 të datës 20 shkurt 2015;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V-737-2015 të datës 15 qershor 2015 lëshuar shoqërisë "EKO -ENERGJI" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Morava e Binçës për HC "Binça me kapacitet të instaluar prej 0.6 MW, ZK Binça, komuna e Vitisë;
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V-737-2015 të datës 15 qershor 2015 për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të hidrocentralit në Lumin Morava e Binçës, HC Binça nga kapaciteti instalues prej **0.6 MW** në kapacitetin instalues prej **1 MW** ZK Binça, Komuna e Vitisë, të datës 25.01.2016 të shoqërisë "EKO -ENERGJI" Sh.p.k., me adresë rruga "Pozharan"p.n. Viti, Republika e Kosovës;
- Vendimin nr. 11-016/48235 dt. 19.01.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit nr. 11-351-11573 i datës 01.04.2015, vetëm në rritjen e kapacitet gjenerues për Lejen Ndërtimore për objektin e Hidrocentralit nga 0.6 MW në 1 MW, e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mjedis, Komuna e Vitisë; dhe
- Vendimin nr. 2881-2/16 –ZSP -45 /16 për ndryshimin e vendimit për Pëlqim Ujor me Nr. 382/15-ZSP-496, të datës 20.10.2016, të lëshuar nga MMPH,

në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2017 nxori këtë:

## V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet **VENDIMI PËR MODIFIKIMIN E AUTORIZIMIT FINAL V-737-2015** i datës 15 qershor 2015, shoqërisë "EKO -ENERGJI" Sh.p.k., për Hidrocentralin në Lumin Morava e Binçës HC "Binça" nga kapaciteti instalues prej **0.6 MW** në kapacitetin instalues prej **1 MW**, sipas Vendimit nr. 11-016/48235 dt. 19.01.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit nr. 11-351-11573 i datës 01.04.2015, vetëm në rritjen e kapacitetit gjenerues për Lejen Ndërtimore për objektin e Hidrocentralit, e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mjedis, Komuna e Vitisë dhe Vendimin nr. 2881-2/16 –ZSP -45 /16 për ndryshimin e vendimit për Pëlqim Ujor me Nr. 382/15-ZSP-496, të datës 20.10.2016, të lëshuar nga MMPH.



- II. **Obligohet** shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, që pas Pranimit Teknik të HC “Binça”, të sjell Certifikatën e Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent I Komunës së Vitisë, dhe Lejen për Shfrytëzim Ujor të lëshuar nga MMPH.
- III. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij vendimi, shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesin Publik në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku tridhjetë (30) ditë para datës së fillimit të operimit gjenerues me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V-810-2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- IV. Shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, obligohet që para se të futet në operim (prodhim) të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

### **Arsyetim**

- ZRRE me datë 13.08.2014 nga shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Morava e Binçës për HC “Binça me kapacitet të instaluar prej 0.6 MW, ZK Binça, komuna e Vitisë.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 21 dhjetor 2014 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_671\_2014, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- ZRRE me datë 20.05.2015 nga shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Morava e Binçës për HC “Binça me kapacitet të instaluar prej 0.6 MW, ZK Binça, komuna e Vitisë, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 15 qershor 2015 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V-737-2015 shoqërisë “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Morava e Binçës për HC “Binça me kapacitet të instaluar prej 0.6 MW, ZK Binça, komuna e Vitisë.
- ZRRE me datë 25.01.2017 nga shoqëria “EKO -ENERGJI” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të hidrocentralit në Lumin Morava e Binçës, HC Binça nga kapaciteti instalues prej **0.6 MW** në kapacitetin instalues prej **1 MW** ZK Binça, Komuna e Vitisë.
- ZRRE ka pranuar s’ bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final: Vendimin nr. 11-016/48235 dt. 19.01.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit nr. 11-351-11573 i datës 01.04.2015, vetëm në rritjen e kapacitet gjenerues për Lejen Ndërtimore për objektin e



Hidorcentralit nga 0.6 MW në 1 MW, e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mjedis, Komuna e Vitisë, Vendimin nr. 2881-2/16 –ZSP -45 /16 për ndryshimin e vendimit për Pëlqim Ujor me Nr. 382/15-ZSP-496, të datës 20.10.2016 nga kapaciteti N= 0.6 MW në N= 1.0 MW, të lëshuar nga MMPH, Pëlqimin Mjedor nr. 16/2467/1-413/DMM, të lëshuar nga MMPH dhe Pëlqimin Elektroenergetik nr. 112 dt. 10.01.2017 të lëshuar nga KEDS Sh.a.


- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura ka vlerësuar ato, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, u.d. kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Vitisë,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.